

## Aktivitetet e “Muajit të Hapur në KLSH” për periudhën 5 – 9 nëntor 2018

Gjatë periudhës kohore nga data 5 nëntor deri në datën 9 nëntor, në kuadër të “Muajit të Hapur” në KLSH u zhvilluan disa aktivitete.

### Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike prezanton dy auditimet më të mira të tij

Në datën 5 nëntor, Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike bëri në Sallën “Lech Kaczynski” bëri prezantimin e dy auditimeve më të mira të tij. Prezantimet në fjalë, u bënë nga dy Audituesit e Lartë z. Alfonc Gabili dhe znj. Nikoleta Piraniani. Fillimisht z. Gabili bëri një përmbledhje të auditimit të bërë në Autoritetin e Aviacionit Civil, Aeroporti i Kukësit.

Në përfundim, rekomandimet e lëna nga KLSH-ja përfshinin: dy propozime për ndryshim legjislativ; 11 masa organizative; 21 masa për shpërblym dëmi në vlerën 259,424 lekë; 10 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në masën 30,281 lekë; 6 masa disiplinore dhe një kallëzim penal.



Pas z. Alfonc Gabili, fjalën e mori znj. Nikoleta Piraniani që bëri një prezantim mbi auditimin e bërë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për projektin “Modernizimi i asistencës sociale”. Ky auditim financiar është bërë në periudhën 23.04.2018 deri më 08.06.2018. *Qëllimi i këtij auditimi ishte se nga KLSH duhet të konfirmohej se për “Ndhmën Ekonomike” (ME) dhe “Pagesat për paaftësi të përkohshme” (PAK) ishin çelur fondet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, referuar financimit buxhetor në sasinë e duhur dhe kohën e duhur (kusht i parashikuar në marrëveshje) dhe se pagesat ishin transferuar në llogaritë përkatëse të përfituesve. Në përmbyllje të fjalës së saj znj. Piraniani tha se nga auditimi kishin rezultuar edhe probleme të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjhershme dhe për nxjerrjen e akteve përkatëse ligjore dhe rregullative.*

Pas përfundimit të dy prezantimeve, mes audituesve që bënë prezantimin dhe të pranishmëve në sallë u zhvillua një seancë diskutimi pyetje-përgjigjesh.

## Prezantime të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore

Aktiviteti i radhës për “Muajin e Hapur 2018” ishte prezantimi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore. Kryeaudituesja Marjola Llanaj ishte audituesja e ngarkuar nga departamenti për paraqitjen e prezantimit të auditimit tek Spitali Universitar i Traumës. Zonja Llanaj e nisi fjalën e saj duke bërë një shpjegim të shkurtër për llojin e auditimit që ishte bërë në këtë rast. Duke qenë një auditim performance dhe përputhshmërie, ai është i veçantë dhe i rrallë në llojin e tij. Kjo pasi është disi e pazakontë të bëhet një auditim i tillë i ndërthurrur mes auditimit financiar dhe atij të performancës. Zakonisht këto dy auditime bëhen veçmas dhë në periudha të ndryshme kohore.

Në fund të auditimit të kryer nga audituesit e KLSH-së u konstatua se:

- SUT nuk ka përgatitur programin e transparencës ku të përcaktojë kornizën ligjore të veprimtarisë së tij, si një mënyrë konkrete përmes së cilës SUT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit duke e përditësuar herë pas here programin e transparencës.
- Mungon faqja zyrtare në web ku mund të publikohet informacioni i programit që synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së SUT-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare i cili duhet të pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afatet kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin (ku çdo dokument duhet të jetë i aksesueshëm edhe në skemë).
- Mungesa e faqes zyrtare të SUT-së nuk mundëson për publikun informacion, pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm dhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve.



Pas përfundimit të fjalës së zonjës Llanaj, ashtu si një ditë më parë, u zhvillua një seancë diskutimi në sallë lidhur kryesisht lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi.

### **Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit prezanton dy auditimet më të mira të tij**

Aktiviteti i fundit, që zhvillohej brenda ambienteve të KLSH-së, për këtë javë ishte prezantimi i dy auditimeve më të mira të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit. Për këtë departament referuan z. Artan Mirashi, Auditues i Lartë dhe z. Dorino Meçe, Auditues i Parë.

Z. Mirashi bëri një prezantim të auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t të Qarkut Shkodër, “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale” për periudhën 01.01.2015 deri më datën 30.07.2017.

Nga ana e audituesve tanë për këtë auditim janë lënë plot 29 rekomandime, nga të cilat:

- 14 masa organizative dhe 4 masë zhdëmtimi me vlerën 2,310,510 lekë, 15 masa disiplinore, nga “vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, si dhe 4 masa për “largim nga puna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10 dhe aktualisht nuk është zbatuar asnjë nga masat e rekomanduara.
- Për shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime për 4 raste me vlerë 2,310 mijë lekë, të arkëtueshëm, nga të cilat, janë pranuar 3, janë zbatuar pjesërisht 3, mbetet në proces arkëtimi i vlerës prej 2,310,510 lekë.
- Nga 15 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 11.



Ndërsa prezantimi i z. Dorino Meçe kishte temën “Mbi problematikat e dala në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë”.



Edhe në këtë prezantim pjesa më pikante ishin rekomandimet, nga të cilat mund të veçojmë:

*“Regjistruesi i ZVRPP Tiranë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, dhe neni 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, bazuar në shkeljet e konstatuara të zbatojë procedurat e mbivendosjes, të mbajë aktin apo relacionin për konstatimin e mbivendosjes sipas rastit, njoftimin e palëve, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë deri në zgjidhjen e problemit të mbivendosjes, si dhe plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ligjor të konstatuar.”*

### **Aktivitetet jashtë vendit**

- Një delegacion i Kontrollit të Lartë Shtetit i përbërë nga 16 auditues, në datat 8-9 nëntor 2018, mori pjesë në një Vizitë Studimore në Prishtinë, të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës.
- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi një Vizitë Zyrtare në SAI-n e Kroacisë, ku mes të tjerash bëri edhe një pasqyrim të “Muajit të Hapur në KLSH”(një informacion i zgjeruar për këtë aktivitet gjendet në WEB e KLSH-së në rubrikën “Njoftime”).